Siguri

# I mituri kapet me armë zjarri në lokal në Pejë

Sinjali.com 22 Mars 2026 09:31

**Një rast i posedimit të paautorizuar të armëve është zbuluar në Pejë, ku një i mitur është kapur me armë zjarri gjatë një aksioni policor.**

Ngjarja ka ndodhur më 21 mars rreth orës 21:50 në rrugën "Xhevat Begolli", gjatë realizimit të një plani operativ për kontrollin e lokaleve dhe personave.

Gjatë kontrollit në një lokal, tek i dyshuari i mitur janë gjetur një armë zjarri e llojit "VZOR 50", kalibër 7.65 mm, një karikator dhe tre fishekë të të njëjtit kalibër.

I mituri është shoqëruar në Stacionin Policor në Pejë dhe është intervistuar në prezencën e prindit dhe avokatit mbrojtës.

Me urdhër të Prokurorit kujdestar për të mitur, rasti është iniciuar si "Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve", ndërsa i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt.

Hetimet lidhur me rastin janë në zhvillim.

***Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!***

**/GazetaSinjali/**

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



All rights are reserved 2025, Copyright Sinjali.com